

Në bazë të nenit 203 të Ligjit për marrëdhënie pune (fl. Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr 62/2005 dhe 106/2008) dhe në përputhje me nenin 5 të Marrëveshjes së përgjithshme Kolektive për sektorin publik të Republikës së Maqedonisë,(fl. Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr 10/2008) , Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë dhe Sindikata e Pavarur e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Republikës së Maqedonisë , më janar 2009, lidhën

MARRËVESHJE KOLEKTIVE
Për ndryshime dhe plotësime të Marrëveshjes kolektive për
Arsimin e mesëm në Republikën e Maqedonisë

Neni 1

Në Marrëveshjen kolektive për Arsimin të mesëm në Republikën e Maqedonisë (“Fl. Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr 65 / 95 dhe 41 / 05 , neni 30 ndryshon dhe thotë

“Neni 30”

Rroga më e ulët e disa shkallëve të ndërlíkueshmërisë për vend pune të plotë dhe kontribut normal i punëtorit, caktohet në mënyrë që shumata e rrogës më të ulët për shkallën më të ulët të ndërlíkueshmërisë, shumëzohet me koeficientin përkatës për shkallën e ndërlíkueshmërisë së vendit të punës dhe kjo :

GRUPI I

E thjeshtë, pune rutine për kryerjen e detyrave të punës :

- punëtor i përgjithshëm

Koeficienti i ndërlíkueshmërisë 1, 00

GRUPI II

Më pak detyra pune të ndërlíkuaara, gjegjësisht punë me mjete më të thjeshta për punë:

- mbajtësi i higjienës

- rojtar

- larëse teshash në shkolla për fëmi me nevoja të posaçme arsimore dhe konvikte në përbërje të shkollave fillore

- shërbyese – enëlarëse në shkolla për fëmi me nevoja të posaçme arsimore dhe konvikte në përbërje të shkollave fillore

Koeficienti i ndërlíkueshmërisë 1, 182

GRUPI III

Punë dhe detyra mesatarisht të ndërlikuara, për të cilat janë të nevojshme njohuri më të ngushta për punën

- ndezës – përdorues të makinave të avullit
- Koeficient i ndërlíkueshmërisë 1, 616

GRUPI IV

Punë të ndërlikuara që kërkojnë individualitet më të madhë në kryerjen e detyrave :

Nëngrupi 1

- ekonom – nikoqir
- gjellëbërës
- mjeshtër shtëpie

Koeficient i ndërlíkueshmërisë 1, 753

Nëngrupi 2

- arkëtar administrativ
- përkujdesës në konvikte

Koeficient i ndërlíkueshmërisë 1, 890

Nëngrupi 3

- bashkëpunëtor në arsimin praktik (demonstrator, laborant dhe bashkëpunëtor tjerë)

Koeficient i ndërlíkueshmërisë 1, 959

GRUPI V

Punë të ndërlikuara që kërkojnë kreativitet në kryerjen e tyre :

- sekretar administrativ

Koeficient i ndërlíkueshmërisë 2, 164

GRUPI VI

Punë më të ndërlikuara të lidhura me zhvillimin e mësimit dhe punëve profesionale, që kërkojnë njohuri plotësuese të lëmisë në të cilën punojnë me pavarësi dhe kreativitet në kryerjen e tyre :

Nëngrupi 1

- arsimtar – fillestar
- edukator – fillestar
- bashkëpunëtor profesional – fillestar
- arsimtar me PLP

- edukator me PLP
- sekretar
- bibliotikist

Koeficient i ndërlíkueshmërisë 2, 369

- Nëngrupi 2
- arsimtar
 - edukator

Koeficient i ndërlíkueshmërisë 2, 575

- Nëngrupi 3
- bashkëpunëtor profesional

Koeficient i ndërlíkueshmërisë 2, 643

- Nëngrupi 4
- arsimtar mentor
 - edukator mentor

Koeficient i ndërlíkueshmërisë 2, 592

Neni 2

Në nenin 32 numrat “0.15” dhe “0,30” zëvendësohen me numrat “0.103” dhe “0.206”.

Neni 3

NË nenin 33 numri “0.20” zëvendësohet me numrin “0, 137”

Neni 4

Në nenin 34 numri “0,20” zëvendësohet me numrin “0,137”

Neni 5

Kjo Marrëveshje kolektive hyn në fuqi, ditën e ardhshme nga dita e shpalljes në “Fl. Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” , kurse zbatimi fillon nga 1 janar 2009.

**Sindikata e Pavarur e Arsimit,
Shkencës dhe Kulturës e
Republikës së Maqedonisë
Kryetar
DOJÇIN CVETANOSKI**

**Ministria e Arsimit dhe
Shkencës e Republikës
së Maqedonisë
Ministër
PERO STOJANOVSKI**

